

# AKSESI I VIKTIMËS NË PROCESIN PENAL

FAKULTETI I DREJTËSISË

Në kuadrin e reformës në drejtësi, Kodi i Procedurës Penale pësoi ndryshime rrënjësore, me qëllim përmirësimin e aksesit në drejtësi të viktimës së veprës penale

## ⇒ Risitë e reformës:

- (i) Parashikimi i viktimës si një subjekt i veçantë dhe me të drejta të plota i procesit penal;
- (ii) Parashikimi i seancës paraprake, si një fazë e ndërmjetme në procesin penal.



## ⇒ Impakti i reformës:

- Garantimi i pjesëmarrjes aktive të viktimës në procesin penal;
- Rehabilitimi social, shëndetësor dhe ekonomik i viktimës = shpërblimi i dëmit material, moral dhe psikologjik; kujdes shëndetësor; ndihmë psikologjike dhe këshillim;
- Rritja e aksesit në drejtësi.

## ⇒ Viktima ka të drejtë:

- Të informohet për gjendjen e procedimit penal dhe të njihet me aktet dhe provat;
- Të njoftohet mbi veprime procedurale;
- Të marrë pjesë aktivisht në procesin penal;

- Të përfaqësohet nga një mbrojtës dhe të përfitojë ndihmë juridike falas;
- Të kërkojë shpërblimin e dëmit.



### ⇒ Parashikimi i Senacës Paraprake:

- Garantohej ushtrimi efektiv i të drejtave të viktimës në fazën e hetimit paraprak;
- Viktima ka të drejtë të paraqesë kërkesa dhe ankime lidhur me zhvillimin e hetimeve;
- Viktima ka të drejtë të njoftohet mbi vendimin për vijimin ose pushimin e akuzës.



### ⇒ Si mund t'i aksesojë viktima të drejtat e saj?

- Nëpërmjet pjesëmarrjes në procesin penal, personalisht ose e përfaqësuar nga një mbrojtës i zgjedhur nga viktima;
- Nëpërmjet paraqitjes së deklaratave, kërkesave dhe ankesave në çdo fazë të procedimit penal: polici gjyqësore, prokurori, gjyqtari i seancës paraprake dhe gjykatë;
- Nëpërmjet paraqitjes së padisë civile në procesin penal.

### ⇒ Kush përfiton nga ndihma juridike falas dhe përjashtimi nga pagimi i shpenzimeve për marrjen e akteve:

- Viktimat që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të pasur një mbrojtës;
- Viktimat e mitura të veprave penale;
- Viktimat e abuzimeve seksuale;
- Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.



FINANCIAR NGA:

FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË